

VENDIM
Nr.1234, datë 16.12.2009

**PËR PËRCAKTIMIN E FORMATIT DHE TË ELEMENTEVE TË NJOFTIMIT PËR
BARRËN SIGURUESE DHE/OSE BARRËN HIPOTEKORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5 të nenit 91 të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Përcaktimin e formatit dhe të elementeve të njoftimit për barrën siguruese dhe/ose barrën hipotekore, mbi masën e sigurimit të detyrimit tatimor, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
Drejtoria rajonale tatimore
Drejtoria e mbledhjes

Nr.. prot,

datë më,....,....09

Format

**NJOFTIM I PËRGJITHSHËM PËR VENDOSJEN E BARRËS SIGURUESE DHE
HIPOTEKORE**

Nga: Drejtoria rajonale tatimore _____

Adresa _____

Njoftim për publikun e interesuar

1. Mbështetur në pikën 5 të nenit 91 të këtij ligji nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve Drejtoria rajonale _____ ka vendosur barrë hipotekore mbi pasurinë e tatimpaguesit:

Tatimpaguesi: _____;

NIPT: _____;

Adresa e biznesit _____.

2. Regjistrimet tona tregojnë se tatimpaguesi i sipërcituar nuk ka paguar në afatin e kërkuar ligjor, detyrimet si vijon:

LLOJI I TATIMIT	SHUMA E TATIMIT	INTERESA DERI NË KËTË MOMENT	GJOBA	GJITHSEJ DETYRIME TATIMORE
----------------------------	----------------------------	---	--------------	---

--	--	--	--	--

3. Tatimpaguesit të sipërcituar i është dërguar dokumenti “Njoftim për pagimin e detyrimit”, por ky detyrim nuk është paguar ende. Këto detyrime tashmë janë subjekt i masave shtrënguese në përputhje me legjislacionin përkatës tatimor.

4. Ky dokument përfaqëson barrën siguruese dhe hipotekore në favor të shtetit shqiptar, përfaqësuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, drejtoria rajonale-----, mbi të gjithë pasurinë dhe të drejtat pasurore, të cilat i përkasin këtij tatimpaguesi, lidhur me shumën e detyrimeve të papaguara në afatin e kërkuar prej tij (tatime, gjoba dhe interes). Vendosja e kësaj barre hipotekore synon të garantojë pagimin e tyre në rast të mospagimit vullnetar.

5. Ky dokument synon të njoftojë të gjitha palët që kanë interesa me këtë tatimpagues.

Në _____, më _____, dita e _____, ora _____

Firma e Drejtorit rajonal të tatimeve

Vula e institucionit

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
Drejtoria rajonale tatimore
Drejtoria e mbledhjes

Nr.. prot,

datë më, ..., ...09

Format

NJOFTIM I PËR VENDOSJEN E BARRËS HIPOTEKORE

Nga: Drejtoria rajonale tatimore _____

Adresa _____

Për: Zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme

Adresa:

Për njoftim: Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme

Adresa:

1. Mbështetur në pikën 5 të nenit 91 të këtij ligji nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria rajonale _____, ka vendosur barrë hipotekore mbi pasurinë e tatimpaguesit:

Tatimpaguesi: _____;

NIPT: _____;

Adresa e biznesit _____.

2. Regjistrimet tona tregojnë se tatimpaguesi i sipërcituar nuk ka paguar në afatin e kërkuar ligjor, detyrimet si vijon:

LLOJI I TATIMIT	SHUMA E TATIMIT	INTERESA DERI NË KËTË MOMENT	GJOBA	GJITHSEJ DETYRIME TATIMORE

3. Tatimpaguesit të sipërcituar i është dërguar dokumenti “Njoftim për pagimin e detyrimit”, por ky detyrim nuk është paguar ende. Këto detyrime tashmë janë subjekt i masave

shtrënguese në përputhje me legjislacionin përkatës tatimor.

4. Ky dokument përfaqëson barrën hipotekore në favor të shtetit shqiptar, përfaqësuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, drejtoria rajonale _____ mbi të gjithë pasurinë dhe të drejtat pasurore, të cilat i përkasin këtij tatimpaguesi, lidhur me shumën e detyrimeve të papaguara në afatin e kërkuar prej tij (tatime, gjoba dhe interes). Vendosja e kësaj barre hipotekore synon të garantojë pagimin e tyre në rast të mospagimit vullnetar.

5. Drejtoria rajonale _____ ka identifikuar këto pasuri të paluajtshme të tatimpaguesit _____ me NIPT _____:

5.1 _____

5.2 _____

5.3 _____

Nëse institucioni juaj disponon të dhëna të tjera mbi pasurinë e paluajtshme të debitorit, brenda 5 ditëve pune duhet të bëni identifikimin e këtyre pasurive dhe vendosjen në hipotekë të tyre në favor të administratës tatimore, deri në momentin që detyrimi tatimor i papaguar prej tatimpaguesit të jetë shlyer.

Në _____, më _____, dita e _____, ora _____

Firma e drejtorit rajonal të tatimeve

Vula e institucionit